

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nations League - VIDEO/ Mbrojtja e Kosovës
ADRESA	https://www.syri.net/sport/919538/video-kosova-peson-te-dytin-ne-fundin-e-pjeses-se-pare-mbrojtja-le-per-te-deshiruar/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 17:01:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ec88176da5e0998097c26503c628b4490080195bec4584eeb4b362b0d4b0fe62
TEKSTI	3e1739a56ab857ef3d49567e3e9331b81c63b3e367d3cf4cd2ebf6a65990960f
PAMJA	39d912b09ec618541502710476694538092b8928b60d89873dfb47f1120436f8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	84e6220092acd2bf41ccf4cce53f902a11ee6bb4a2559d6942768706fd2ebdd5
E MËPARSHMJA	8dc03ab132bf11042e7907135d9ff76e4b03ab93d96210d2e1b1ec694c82d8cb
RRËNJA MERKLE	67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728bdbf8bf8d029d400ef1ab927ee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/84e6220092acd2bf41ccf4cce53f902a11ee6bb4a2559d6942768706fd2ebdd5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ÇIM PEĐA**
'Nuk e dija, nuk mjafton më'**FATMIR MEDIU**
Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

LAJMI I FUNDIT

LIVE - 'Rama jepe dorëheqjen', protesta e 120-të, shqiptarët rezistencë kundër qeverisë



më të lexuarat

Manchester United shet copëza të fushës së vjetër të 'Old Trafford'

Rekordi i Rivas reziston prej më shumë se 50 vitesh, alarm për sulmin e Italisë

Gjermani-Greqi, formacionet zyrtare: Bisseck titullar, dy 'italianë' në stol

Klopp jep përditësimin për Musiala-n dhe Havertz-in pas dështimeve

Holandë-Gjermani (20:45), përballje gjigantësh në një epokë të re

Danimarka mposht Uellsin dhe thellon krizën e 'Dragonjve' në Nations League

f
t
o
o
o
o
VIDEO/ Mbrojtja e Kosovës 'fut ujë', Zhegrova 'zbut' humbjen e thellë ndaj Austrisë

20:00, 27/09/2026

Kosova pëson humbje në ndeshjet e dytë të këtij edicioni të Nations League, përballë Austrisë në transfertë. Pjesa e parë ishte e një niveli të dobët të dardanëve, sidomos në fazën mbrojtëse. Edhe pjesa e dytë nisi keq, me golin e tretë të vendasve, ndërsa goli i vonë i shënuar nga Zhegrova me 11-metëresh vetëm sa e zbuti disfatën e thellë.

Austria ka kaluar herët në avantazh 1-0 ndaj Kosovës. Goli i parë i takimit erdhi në minutën e 23-të. Romano Schmid ekzekutoi një goditje dënimi dhe dërgoi topin në zonë, ku David Affengruber u shkëput nga mbulimi dhe goditi saktë me kokë nga pranë zonës së vogël, duke e dërguar topin në rrjetë.

Fillimisht pati dyshime për një pozicion jashtë loje në aksionin e golit dhe arbitri Nick Walsh u sinjalizua nga VAR-i për ta rishikuar episodin. Pas kontrollit, në minutën e 26-të, goli u konfirmua dhe Austria ruajti avantazhin 1-0.

Austri - Kosovë 1-0

Kosova kishte mundësinë më të mirë përpara golit austriak. Në minutën e 6-të, Vedat Muriqi mori një pasim të bukur brenda zonës dhe provoi me gjuajtje, por topi kaloi pak mbi traversë.

Në minutën e 27-të, Ermal Krasniqi u rrëzua brenda zonës pas një dueli me një lojtar austriak. Futbollistët e Kosovës kërkuan penallti, por arbitri Walsh vendosi të mos e ndëshkojë ndërhyrjen dhe loja vijoi.

Austria ka shënuar edhe golin e dytë ndaj Kosovës, duke e mbyllur pjesën e parë në avantazhin 2-0.



Austria [2]-0 Kosovo - Junior Adamu 45+2'

by
u/xggq in

Raphinha: Flick më ndryshoi mentalitetin, Yamal duhet të fitojë Topin e Artë

Kosova nis aventurën në Ligën B ndaj Irlandës (20:45) pa kapitenin Rrahmani

Konatë dëmtohet me Francën, rikthehet te Real Madridi

Në minutën e 45+3', Junior Adamu realizoi një gol të bukur pas një aksioni të rrjedhshëm të skuadrës austriake. Sulmuesi mori një pasim perfekt në zonë dhe goditi saktë e ulët në qendër të portës, duke mos i dhënë asnjë mundësi portierit të Kosovës për të reaguar.

Austria shkon kështu në dhomat e zhveshjes me një epërsi të dyfishtë, ndërsa Kosova do të ketë një mision të vështirë në pjesën e dytë.

Austria ka shënuar edhe golin e tretë ndaj Kosovës, duke e çuar rezultatin në 3-0 në minutën e 61-të.

Carney Chukwuemeka përfitoi nga një top i kthyer në zonën e rreptësisë dhe reagoi shpejt, duke e dërguar topin me goditje të ulët në këndin e poshtëm të djathtë të portës.

Austria thellon kështu avantazhin dhe e vendos Kosovën përballë një detyre shumë të vështirë në minutat e mbetura të takimit.

Austri - Kosovë 3-0

Kosova ka gjetur golin e parë ndaj Austrisë, duke ngushtuar diferencën në 3-1 në minutën e 83-të. Edon Zhegrova mori përgjegjësinë dhe realizoi me qetësi nga pika e bardhë e penaltisë, duke e dërguar topin në këndin e poshtëm të majtë të portës, jashtë mundësive të portierit Christian Zawieschitzky.

Austri - Kosovë 3-1

“  Zhegrova goal for Kosovo. <https://t.co/e9EYOvD6v0>
— Juventus Xtra (@juven_xtra) September 27, 2026

© SYRI.net

Lexo edhe:



Danimarka mposht Uellsin dhe thellon krizën e 'Dragonjve' në Nations League



Gjermani-Greqi, formacionet zyrtare: Bisseck titullar, dy 'italianë' në stol



Ancelotti 'kopjon' Flick-un, Raphinha pritet të luajë si '9' te Brazili

Bëje LIKE dhe merr lajmin e fundit nga Sporti:

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



Keane i përgjigjet Rodrit: Ishte vendimi i klubit të mashtronte



VIDEO/ 'Dopietë' e Mexx Meerdink, Holanda mposht Serbinë në Beograd



Nations League, Lituania ndalet në barazim ndaj Azerbajxhanit



Mancini para Turqisë: Asnjë presion, shoh shumë nervozizëm. Edhe para Europeanit nuk kishte besim



Si është gjendja e Pablo Osvaldos? Familja qetëson: Është i kthjellët dhe nuk është nën sedacion



Kosova me ndryshime ndaj Austrisë, Edon Zhegrova e nis nga stoli



Karius rilind te Schalke: Ka portierin më të mirë jo vetëm të Bundesligës, por të gjithë Gjermanisë

[LAJME](#) [POLITIKË](#) [KRONIKË](#) [EKONOMI](#) [KOSOVA](#) [BOTË](#) [KULTURË](#) [SHKENCË](#) [SPORT](#) [JETË/STIL](#) [TRASHËGIMI](#) [MEDIË](#) [ARKIVA](#)



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.